



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:093618

Datë: 24.03.2021

Numri i dokumentit: 01629205

**P.nr.399/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit, F. (Sh.) K. nga K.....,Rr“.....”nr19, për shkak të veprës penale, “asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par1”,të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë,PP/II Nr.763/19,të dt 19.04.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 22.03.2021, në prezencë të prokurorit të shtetit, Muharrem Bajraktari, të akuzuarit F. K. , dhe në mungesë të palës së dëmtuar Kompania KEDS, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari F. K.** , i biri i Sh. dhe i nënës M. e gjinisë K., i lindur me datë ....., në ....., tani me banim në .....,Rr “..... nr19”, me profesion menaxher i kompanisë “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, i martuar baba i 4 fëmijëve, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt. 14.03.2019,rreth orës 16:00,në f.sh .....,K-.....,pikërisht në subjektin afarist NPT “.....”, me dashje dëmton pasurin e luajtshme të dëmtuarës,KEDS SH.A(kompania kosovare për distributim dhe furnizim me energji elektrike) ,në atë menyrë që me rastin e ndërrimit të njësorit elektrik,nga ana e punëtorve te autorizuar të dëmtuarës “KEDS”-Distrikti nëPejë,S. T.,E. I. dhe R. Z.-dëshmitar,të cilët posa e vendosin njësorin e ri elektrik,tek i pandehuri, më anë të një guri,e thyen njësorin e ri elektrik,dhe këtë në prezencën e dëshmitarëve të sipërcekur,me ç’rast të dëmtuarës Kompanisë “KEDS sh.a”,i shkakton dëme materiale .

**-Me çka ka kryer vepër penale, asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së,**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,73, të KPRK-së, neni 333 par 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit F. K. i shqipton:

## **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarit F. K. , i cakton dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqindë euro ) e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20€ (njëzetë euro), si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€ (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar Kompania "KEDS sh.a", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme ka ngritur aktakuzë PP/II Nr.763/19,të dt 19.04.2019, kundër të akuzuarit F. K. nga ....., për shkak të veprës penale , asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datë 22.03.2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II Nr.763/19,të dt 19.04.2019, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari i ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe e pranon fajësinë për veprë penale me të cilën ngarkohet, paraprakisht kërkoj falje para gjykatës për veprimet e mija në atë moment nuk kam mundur të kontrolloj veprimet e mija të momentit, për faktin që kam pasur probleme të vazhdueshme, me energji elektrike dhe firma ka 20 puntorë dhe shumë herë u pamundësohej puna normale shkak i mungesës së energjisë elektrike, por sido çoftë ndjej keqardhje dhe jam i penduar,poashtu i premtoj gjykatës se nuk do të përsëriti veprime të tilla,në të ardhmen dhe jam i gatshëm që të kompensoj dëmin e shkaktuar.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, meqenëse i njëjti e ka pranuar fajin duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion, konsideron se i njëjti pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit, vlerësoi se pranimit i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë:deklarata e të pandehurit F. K. e dhënë në polici me dt 20.03.2019,deklarata e dëshmitarve S. T.,Sh. H. e dt.15.03.2019 e dhënë në polici,raporti i policit H. R. i dt.15.03.2019,raporti mbi kontrollim kontrollim-pranim e grupit matës më nr.0067569 i dt.14.03.2019,procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës më nr.018357 i dt.14.03.2019,si dhe fotodokumentacionet dhe shkresat tjera të lëndës,andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë, i vie keq, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar, pati sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk ka gjetur asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KRPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar Kompania "KEDS sh.a", për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.399/19**

**Sekretare juridike**  
**Lindmire Begolli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ahmet Rexhaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.